



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
ZYRA ME NJË NDALESË**

Nr. _____ Prot.

Maliq, më: 12.09.2019

Procesverbal

I mbajtur në dëgjuesën publike për Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, në Njësinë Administrative Vreshtas.

Në kuadër të Ligjit 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, Ligjit 119/2014, “Për të drejtën e informimit publik”, dhe Ligjit nr. 146/2014, neni 18 “Pjesëmarrja në takime Publike”, u mbajt sot, më dt. 12.09.2018, ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Njesisë Administrative Vreshtas, takimi konsultativ (dëgjesa publike) mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2019-2021, si dhe për buxhetin vjetor, pjesë e buxhetit afatmesëm.

Në takim morën pjesë: Kryetari i Bashkisë Maliq, z. Gëzim Topçiu, Deputeti i zonës, z. Ilirjan Pendavinji, drejtues dhe specialistë të Bashkisë Maliq, banorë të Njesisë Administrative Vreshtas, kryetarë të Fshatrave, përfaqësues të bizneseve, shoqatave, si dhe grupe të tjera të interesit.

Në vijim të procesit të hartimit dhe përgatitjes së Programit-Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021, dhe për buxhetin vjetor 2019, takuam dhe dëgjuam banorët e Njesisë Administrative Vreshtas, për të vendosur së bashku prioritetet e investimeve reale, që do të realizohen nga Bashkia Maliq, me qëllim përmirësimin e jetesës në çdo fshat, ku këta banorë jetojnë. Gjatë diskutimit, në thelb të dëgjësave publike ishin, jo vetëm punët dhe investimet e kryera nga Bashkia Maliq gjatë këtyre tre viteve, por dhe kërkesave e nevojave thelbësore në lidhje me përmirësimin e një sërë shërbimesh si ç’janë:

1. Shqetësim mbetet përmbytja e parcelave bujqësore, konkretisht u kerkua: Pastrimi i kanalit nr. 4, pastrimi i kanalit 11/2, 1 km kanal që të nxjerr të ura e Sovjanit.
2. Rehabilitimi dhe sistemimi i rrugëve të brendshme në fshatin vreshtas, kishnik, Podgorie lart.
3. Asfaltimi i rruges, Podgorie lart.
4. Riparimi apo nderhyrja në Cistinat, për të ndërtuar një prite për të mos lejuar hyrjen e ujit që nga Korita për në Parcelat e fshatit Vreshtas..
5. Kanalizimi i ujerave të zeza në lagjen Kupole të fshatit Podgorie.
6. Ndricimi në fshatin Kishnik.
7. Ndërtimi i një qendre shëndetësore në fshatin Kishnik.

Theksi u vendos dhe tek përmirësimi i disa objekteve, si kopshte, shkolla, furnizimi me dru zjarri etj. Takimi u hap me fjalën e Kryetarit të Bashkisë Maliq, e cila u pasua me prezantimin e Programit Buxhetor për periudhën 2019-2021, u bë një analizë e investimeve dhe punëve që janë kryer nga Bashkia Maliq gjatë kësaj periudhe, si dhe u propozua hedhja e ideve dhe mendimeve të banorëve

të komunitetit për të përcaktuar prioritetet e investimeve dhe alokimin e fondeve sipas nevojave dhe kërkesave të komunitetit. Pas prezantimit u vijua me komente dhe pyetje të pjesëmarrësve, të cilëve i'u përgjigjën drejtues dhe specialistë të Bashkisë që mbulojnë sektorët përkatës.

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

Stiljan Belishta